



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 51, datë 21.05.2024

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR DHE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE, TË PRONËS ME NR. 4, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, MIRATUAR ME VKM NR.538, DATË 07.8.2012, ME EMËRTIMIN "TRUALL", ME NR. PAS. 10/34, ZK 2590, KUÇOK, MANËZ NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË SHKOLLËS SË MESME KUÇOK, MANËZ

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronjat "a" dhe "c", të nenit 23, pika 11, nenit 54, neni 55, pika 2 dhe 6, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, nenit 3, të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë", i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pronës me nr. 04, e llojit “Truall”, me nr. pas.10/34, ZK 2590, Kuçok, Manëz, transferuar në pronësi me VKM nr.538, datë 07.8.2012 të ish Bashkisë Manëz (me ndarjen territoriale, sot Bashkia Durrës), me qëllim realizimin e programeve arsimore parauniversitare.
2. Miratimin e përditësimit të pronës me nr.4, të listës për transferim, me emërtimin “Truall”, me nr. pas.10/34, ZK 2590, që i përket Shkollës së Mesme Kuçok, Manëz, sipas formularit të përditësimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



Lidhja 1

Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manëz

Numri rendori pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
04	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 328/4 prot.

Durrës, më 29.05 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

BASHKIA Durrës
29.05.24 Nr. 5972/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.51 datë 21.05.2024 “Për miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar dhe përditësimin e të dhënave të pronës me Nr.4 të listës së transferimit, miratuar me VKM nr.538 datë 07.08.2012, me emërtimin “Truall”, me nr.Pas. 10/34, ZK 2590, Kuçok, Manëz në funksion të ndërtimit të shkollës së mesme Kuçok, Manëz”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

